

VENDIM
Nr. 314, datë 9.5.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 140, DATË 17.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA
SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 2 shkronja “c” dhe 26 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 26 të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 5 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 140, datë 17.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha